

KONTRATË SHITJE KUOTE

Sot, me 1 nentor 2021 (dymije e njezete e nje), palet e meposhtme:

Shitësi: Refation Dobi, atësia Sadik, amësia Pashe, shtetas Shqiptar, lindur në Gjirokastërdhe banues në TIRANË, me adresë Muhamet Gjollësia; Nd. 59; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 14/10/1986, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037341019 dhe nr. personal I61014041H;

dhe


Blerësi: Relianda Zhelegu, atësia Viktor, amësia Dhurata, shtetase Shqiptare, lindur në Gjirokastër dhe banuese në TIRANË, me adresë Margarita Tutulani; Nd. 1; H. 29; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 15/04/1979, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034179939 dhe nr. personal H95415207H;

MEQENESE:

- A. Shitësi zotëron 100% te Kapitalit te Shoqërisë "INFINITY DESTINATIONS" Sh.p.k, një shoqëri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT M11921027K, me seli ne adresen: Rruga "Pjeter Bogdani", Nr. 13, Kati i pare, Tirane, Shqiperi. (me poshte referuar "*Shoqëria*");
- B. Shitesit deshirohet t'i shese Bleresit dhe Bleresi deshirohet te bleje nga Shitesit kuotat e kapitalit qe Shitesit zoteron ne kapitalin e Shoqerise, gjithsej 100% te Kapitalit te Shoqërisë së lartpërmendur;
- C. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, si dhe me vendimin bashkelidhur te Ortakut te Vetem te Shoqerise dhe te blesit, Palet deshirojne te lidhin kete Kontrate.

PER SA ME SIPER, palët bien dakord si vijon:

1. Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Shitesit i shet Bleresit dhe Bleresi blen nga Shitesit 100% te kapitalit te Shoqerise "INFINITY DESTINATIONS" Sh.P.K. Shitësi deklaron dhe garanton se ka marrë nga Blerësi, në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord prej 100 Leke (njëqind leke) perpara nenshkrimin te kontrates dhe për këtë arsye transferon këtu kuoten e zotuar prej tij në Kapitalin e Shoqërisë në pronësi të Blerësit. Shitesit deklaron e garanton se nuk ka asnje pretendim te cfaredolloji ne lidhje me pagimin e cmimit te shitjes dhe shprehimisht heq dore nga cdo pretendim i mundshem. Palet deklarojne e garantojne reciprokisht njera-tjetren se cmimi i shitjes se kuotes eshte i drejte, i arsyeshem dhe i caktuar me vullnetin e lire e te plote te paleve.



2. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se pjeset e kapitalit të transferuara këtu, janë në pronësi të tij të plote e ligjore dhe të lira nga barra hipoteke apo pengje.
3. Blerësi blen 100 % të kapitalit të Shoqërisë dhe me nënshkrimin e kësaj Kontrate bëhet ortak i vetëm i Shoqërisë. Blerësi pranon pronësinë e Kuotes duke njohur gjendjen e Shoqërisë dhe bie dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i kuotes, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit.
4. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të Kuotes objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër Shqiptar sipas përcaktimeve të ligjit.

Kjo Kontrate u hartua në 3 (tri) kopje origjinale në gjuhën Shqipe. Kontrata bazohet në nenin 705 e vijues të Kodit Civil dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar. Palet deklarojnë se nënshkruajnë me vullnet të lirë e të plotë rregullisht sipas ligjit.

PALET

SHITESI

Refation Dobi

Refation Dobi



BLERESI

Relianda Zhelegu

Relianda Zhelegu
RZ